



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:277902
Datë: 12.01.2022
Numri i dokumentit: 02597390

PN-II-nr.1/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Valdete Daka kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurës L. S. për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 par. 1 të KPRK dhe veprës penale vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336 par. 1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të pandehurës av. Rrustem H. Latifaj nga Gj., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.I.DP.nr.1542/2021 të datës 21.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurës L. S., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PN.I.DP.nr.1542/2021 të datës 21.12.2021.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjiilan – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPr.nr.296/2021 të datës 11.12.2021, e ka refuzuar kërkesën e prokurorit për caktim të paraburgimit dhe të pandehurës L. S. i ka caktuar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale, mashtrimi nga neni 323 par. 1 të KPRK dhe veprës penale vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336 par. 1 të KPRK, ashtu që sipas këtij aktvendimi kjo masë mund t'i zgjasë deri me datën 08.01.2022, masa e arrestit shtëpiak i është caktuar konform dispozitës së nenit 189 par. 4 lidhur me nenin 183 par.1 nën par 1.1 e 1.2 e lidhur me nenin 187 par.1 nën par 1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit në Prishtinë, me aktvendimin e PN.I.DP.nr.1542/2021 datës 21.12.2021, ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjiilan dhe e ka ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë, ashtu që të pandehurës ia ka caktuar masën e

paraburgimit konform dispozitës së nenit 187 par. 1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, e cila masë do t'i zgjasë deri më datë 08.01.2022.

Kundër këtij aktvendimi, në afat ligjor, ankesë ka paraqitur, mbrojtësi i të pandehurës av. Rrustem H. Latifaj, për shkak të ndryshimit të masës së arrestit shtëpiak me masën e paraburgimit, me propozim që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet dhe e pandehura të lirohet nga paraburgimi.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtresën PPAIII.nr.1/2022 datë 10.01.2022, propozon që ankesa e mbrojtësit të të pandehurës të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi në ankesën e tij ka theksuar se zëvendësimi i masës së arrestit shtëpiak me masën e paraburgimit nuk është i arsyeshëm ngase edhe me masën e arrestit shtëpiak plotësohen kushtet për zhvillimin e rregullt të procedurës penale kundër të pandehurës. E pandehura edhe pse është në moshë të re, masën e arrestit shtëpiak e ka respektuar dhe nuk është larguar dhe nuk ka bërë asnjë lëvizje më të vogël dhe ka qenë shumë e kujdesshme gjë e cila është vërtetuar edhe nga ana e zyrtarëve policorë nga të cilët nuk ka pasur asnjë vërejtje. Nuk qëndrojnë bazat ligjore sipas dispozitës së nenit 187 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 të KPP ngase e pandehura nuk është fshehur, identitetin e ka të vërtetuar, ka vendbanim të caktuar dhe se nuk është arsyetuar me asnjë rrethanë mundësia e ikjes apo largimit nga vendi. Po ashtu nuk ka mundësi të ndikimit, asgjësimit, ndryshimit dhe falsifikimit të provave të veprave penale si dhe se nuk është provuar me asnjë provë se e pandehura do të mund të përsëriste veprat penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme ankimore të mbrojtësit janë të pabazuara, sepse provat e mbledhura deri më tani, kallëzimi penal me numër të rastit 2021-CA-1243 të datës 09.12.2021, deklarata e të pandehurës, dëshmitarëve si dhe provat tjera, mbështesin dyshimin e bazuar se e pandehura mund të jetë kryese e veprave penale për të cilat dyshohet. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e Apelit ka dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare me rastin e caktimit të paraburgimit ndaj të pandehurës konform dispozitës së nenit 187 par. 1 nën par. 1 e 2 pika 1.2.1. të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale me çka do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu ekzistojnë ka bazë ligjore konform nenit 187 par. 1 nën par. 1 e 2 pika 1.2.2 të KPP për faktin se në këtë çështje penale hetimet janë ende në zhvillim e sipër, e gjatë të cilave do mblidhen edhe prova të tjera për zbardhjen e kësaj çështje penale, andaj ekziston frika e bazuar se po të gjendet e pandehura në liri do të mund të ndikojë në të dëmtuarin N. R. dhe dëshmitarët L. M. dhe A. H. dhe në këtë mënyre do të pengojë zhvillimi i normal i procedurës në këtë çështje penale

Kjo Gjykatë, gjithashtu vlerëson se qëndron edhe baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit nga neni 187 par. 1 nën par 1 e 2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat dyshohet se i ka kryer këto vepra, pastaj faktin se e pandehura ka pasur qëllimin e përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë, me paraqitjen e fakteve të rreme, duke mashtruar dhe duke përdor identitet të rremë janë

rrethana të cilat e arsyetojnë frikën se me gjetjen e të njëjtës në liri do të mund të vie deri tek përsëritja e veprave penale të njëjta, apo të ngjashme penale.

Duke pasur parasysh rrethanat e lartcekura, kjo gjykatë konsideron se masat tjera do të ishin të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurës në procedurën penale dhe se pretendimet ankimore të mbrojtësit nuk janë të bazuara. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, caktimi i paraburgimit si masë e sigurisë për praninë e sajë në procedurë dhe përfundimin e papengesë të saj, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 411 par. 8 lidhur me nenin 416 par. 2 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË
Pn-II-nr.1/2022 më datë 11.01.2022

B.Profesionale
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit
Valdete Daka